

## **Workshop-i i përbashkët i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shoqatën “Qëndresa Qytetare” .**

Në datën 30 tetor 2020 Kontrolli i Lartë i Shtetit në bashkëpunim me shoqatën “Qëndresa Qytetare” organizuan workshop-in me temë “*Ndërveprimi dhe shkëmbimi i përvojave mes audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe analistëve të Qëndresës Qytetare*”.

Në fjalën e çeljes, Kryeaudituesi, z. Aulent Guri u shpreh se: KLSH ka krijuar tashmë një traditë të konsoliduar sa i përket bashkëpunimit me botën akademike, ekspertët e pavarur dhe organizata të ndryshme jo fitimprurëse me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira, por edhe problematikave që ndeshen në punën audituese.

Drejtori Ekzekutiv i shoqatës “Qëndresa Qytetare”, z. Rigels Xhemollari u shpreh se: bashkëpunimi mes KLSH-së dhe kësaj shoqate është i natyrshëm dhe i nevojshëm në luftën kundër korrupsionit, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e qeverisjes.



Nga audituesit e KLSH-së u prezantuan auditimet e performancës:

- Efektiviteti i kushteve për zhvillimin strategjik të turizmit;
- Cilësia e godinave të shkollave parauniversitare;
- Cilësia e Ajrit;
- Cilësia dhe siguria e barnave në rrjetin e hapur farmaceutik dhe shërbimin spitalor;
- Efektiviteti i kasave fiskale në rritjen e të ardhurave tatimore.

Në fokusin e monitorimeve të kryera nga analistët e shoqatës “Qëndresa Qytetare” ishin masat e ndërruara nga qeveria në fushën e ekonomisë dhe shëndetësisë si pasojë e pandemisë, si dhe raportet për çështjet e arsimit dhe kulturës.

Në përfundim të aktivitetit Kryeaudituesi, z. Guri theksoi se puna audituese e KLSH-së do të vazhdojë me të njëjtin ritëm duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së, dhe planin e saj të veprimit duke i fokusuar auditimet e performancës tek: reformat qeveritare; projektet dhe shërbimet social-ekonomike; projektet infrastrukturore; projektet mjedisore dhe energjitike, si dhe projektet dhe shërbimet social-kulturore.



Duke folur për prioritetet e shoqatës “Qëndresa Qytetare” deri në fund të vitit 2020, Drejtori Ekzekutiv i shoqatës, z. Xhemollari nënvizoi se çështjet që do të hulumtohen nga analistët janë:

- Aksesi në arsim dhe cilësia e mësimdhënies;
- Përballimi i situatës së pandemisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kushtet në Spitale;
- Biblioteka Kombëtare dhe zonat e mbrojtura arkeologjike. Investimet, transparenca dhe sfidat;
- Turizmi dhe Mjedisi përballë njëra-tjetrës. Ndërtimi i Aeroportit të Nartës dhe aktiviteti i Inspektoratit të Mjedisit;
- Projekti Shqipëria 1 Euro. Analiza e përfitimeve dhe e zbatimit të ligjit.

Përfaqësuesit e dy institucioneve ranë dakord për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm mbi tematikat nën auditim e monitorim, duke e kthyer modelin e këtij workshop-i në një praktikë të vazhdueshme me qëllim përfitimin e ndërsjelltë.